

**STATUTI I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“FT INFORMATION TECHNOLOGY” SHPK**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**FT INFORMATION TECHNOLOGY**” Sh.p.k. dhe zoterohet nga themeluesi:

1. **ALIKO FABJAN**, atësia **BAJRAM**, shtetas SHQIPTAR, lindur më 09/01/1992 në Zhulat, me rezidencë në: rruga Shefqet Kuka, nr.20 Fresku, Tirane, Shqipëri. Me nr kartë identiteti J20109078L.

Në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosi të hartojnë këtë statut të shoqërisë “**FT INFORMATION TECHNOLOGY**” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

## **KAPITULLI I**

### **EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI**

#### **NENI 1**

#### **FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formën e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërise. Kjo shoqëri i përballon humjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të shoqërise.

Emri i shoqërise është “**FT INFORMATION TECHNOLOGY**” Shpk.

#### **NENI 2** **BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithesi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

#### **NENI 3** **SELIA**

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Ismail Qemali, pallati nr 27, shkalla, 1, kati i shtatë, Njësia Bashkiake nr.5, 1019 Tiranë, Shqipëri. Në adresën e mësipërme do të identifikohet qëndra e personit juridik.

## **NENI 4 TERRITORI**

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërise. Zyrat, filialet ose përfaqësítë e shoqërise jashtë territorit të Republikës së Shqipërise do të zhvillojne veprimtarine e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatese.

## **KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË DHE VEPRIMTARIA**

### **NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria " FT Information Technology " Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie Shpk që merret me:

web marketing; promoción online; call center hyres dhe dales; Aktivitet ne fushen e ofrimit te sherbimeve te ndryshme online; "telefonata ne Web"; Aktivitet kerkimor, perzgjedhje, orientim, trajnim dhe aktivitete menaxheriale dhe profesionale trajnimi me sisteme multimediale dhe sisteme ne largesi; Aktivitet ne fushen e organizimit te seminareve, takime, konferanca, organizime te per gjithshme dhe aktivitetave te promovimit te imazhit. Aktivitet ne fushen e tregtise elektronike edhe per llogari te paleve te treta; Perdorimi i sistemeve kompjuterike ne fushen e studimit dhe kontrollit. Perdorimi i sistemeve te informacionit territorial (GIS).

Shoqeria mund te marre pjese ne cilesine e ortakut apo te aksionerit ne shoqeri te tjera tregtare me objekt te njejtë ose te ndryshem.

Ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, ne menyre qe te arrije objektin e 2 lartpermendur, shoqeria mundet gjithashtu: Te kryeje çdo transaksion lidhur me asetet e luajtshme ose pasurite e paluajtshme, vendosja e pengjeve, hipotekes, barreve si dhe aktivitete te cilat mund te konsiderohen te nevojshme per te arritur aktivitetin e Shoqerise. Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.

### **NENI 6 KOHËZGJATJA**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar, Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi me vendim të Administratorit, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

**KAPITULLI III  
KONFIDENCIALITETI, DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT**

**NENI 7  
KONFIDENCIALITETI**

Administratori i shoqerisë dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojne asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

**NENI 8  
DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT**

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshmëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

**KAPITULLI IV KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE  
TRASFERIMI I TYRE**

**NENI 9  
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Lekë (njëqindmijë), i ndarë në 1 (një) pjesë.  
Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

- |                |                     |
|----------------|---------------------|
| - FABJAN ALIKO | 100 % - 100.000 LEK |
|----------------|---------------------|

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dinte.

**NENI 10  
TË DREJTAT E ORTAKËVE NË LIDHJE ME KAPITALIN**

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të administratorit.

**NENI 11  
FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT**

Fusha e autoritetit të ortakut, përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kontributin e tij në kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gjëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

## **NENI 12** **FINANCIMI I SHOQERISE**

12.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortaku fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërisë.

12.2 Financimet e mëtejshme të ortaku do të janë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

## **NENI 13** **TRASFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT**

13.1 Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të trasferohen lirisht tek persona të tretë vetëm pasi ortaku ishoqërise në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

13.2 Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkshorti, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë nëpërmjet trasferimit të pjesëve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

13.3 Trasferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt notarial dhe të depozitohen në organin kompetent.

## **KAPITULLI V** **ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

### **NENI 14** **ORGANET DREJTUESE**

14.1 Organi drejtues i shoqërise do të jetë Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësoje shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise do ti referohemi me termin Ortaku i vetem.

14.2 Shoqëria mund të emeroje më shume se një Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "**FT INFORMATION TECHNOLOGY**" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer.

Administratori i shoqërisë për një periudhë 4 (katër) vjeçare është emeruar ortaku **Fabjan Aliko**.

## **NENI 15** **ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ**

21.1 Kompetencat e Administratorit ose të Administratorëve, të cilët mund edhe të mos jenë ortakë të shoqërisë, në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohën në aktin e tyre të emërimit. Veç të tjeravë që mund të detajohen në këtë akt, Administratori ka edhe këto kompetenca:

- Kujdeset përfunksionimin e përditshëm normal të shoqërisë ose të një pjese të aktivitetit ekonomik dhe financiar të saj, sipas përcaktimit në aktin e emërimit.
- Përgatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme përgjendjen ekonomike dhe financiare të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi.
- Koordinon veprimtarinë e personave të punësuar në shoqëri.
- Ndjek problemet e shoqërisë në marrëdhene me organet shteterore ose cakton ndonjë prej personelit për trajtimin e këtyre problemeve.
- Percakton tarifat e shërbimeve dhe pagat për personelin e punësuar në shoqëri.
- Administratorët kanë të drejtë të gjithë së bashku ose veçmas nga njëri tjëtri të përfaqësojnë shoqërine në lidhje me të tretët.

21.2 Administratori ose Administratorët janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose përfajë të kryera gjatë ushtrimit të administrimit të shoqërisë. Përgjegjësia është individuale ose solidare, kjo në varesi të rrethanave dhe të menyrës se si është vepruar, pra individualisht ose solidarisht.

21.3 Administratori o Administratorët nuk janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose të tretëve për konfliktin e interesit që mund të krijohet duke zhvilluar posicione të ndryshme ose të ngjashme në shoqëri dhe organizma të ndryshëm.



## **KAPITULLI VI KONTROLLI KONTABËL, BILANCI, DIVIDENTET**

### **NENI 22 KONTROLLI KONTABËL**

Kontrolli i jashtëm kontabël i shoqerisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi. Administratori do të emerojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët në bazë të ligjit.

### **NENI 23 BILANCI DHE REZERVAT**

23.1 Bilanci mbylljet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiarë dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar, i paraqiten për shqyrtim ortakut te vetem, i cili vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e këtyre akteve, kur e konsideron të nevojshme ortaku mund të bëjë rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çështjen në diskutim.

23.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i vetëm merr masat e nevojshme për hartimin e projekt-bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që ortaku të vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brënda afateve të përcaktuara nga ligji.

## **KAPITULLI VII MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISE, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE**

### **NENI 24 MBARIMI**

Shoqeria mbaron me vendim të të Ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

### **NENI 25 LIKUJDIMI**

25.1 Shoqeria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e ketij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin atij rapportin mbi

gjëndjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

25.2 Në fund të procesit të likujdimit, ortaku vendos mbi bilancin përfundimtar financier dhe mbi mbylljen e proçesit të likujdimit.

25.3 Mbas pagimit te kreditorëve Ortaku mban pjesën e mbetur të kapitalit që u shperndahet ortakëve.

## **KAPITULLI VIII** **MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA TË FUNDIT**

### **NENI 27** **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Çdo mosmarrëveshje a konflikt ne lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortaku do të angazhohen se do ta zgjidhe me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

### **NENI 28** **DISPOZITA TË FUNDIT**

28.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me ligjin shqiptarë. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjislacioni shqiptarë në përgjithsi.

28.2 Shoqëria do të ketë vulën, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhësite do te percaktohen nga ortaku.

28.3 Ky Statut është hartuar ne 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKU E SHOQËRISË  
“FT INFORMATION TECHNOLOGY” SH.P.K.  
FABJAN ALIKO**

07. 11 / 03 / 2021

